



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE
DREJTORI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __. __. 2025

RAPORTI I PERFORMANCËS
PËR VITIN 2024

Në kuadër të realizimit të raportit të performancës, për sa i përket veprimtarisë së Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, po ju paraqesim një pasqyrë gjithëpërfshirëse të punës së institucionit bazuar në përmbushjen e detyrave dhe qëllimeve mbi të cilat QPKMR ushtron aktivitetin e saj, konkretisht në parandalimin e kriminalitetit dhe të recidivizmit të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin.

Referuar aktit në bazë të të cilit është ngritur dhe funksionon ky institucion, VKM-së nr. 314, datë 15.05.2019, “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, të ndryshuar, përcaktohet se, QPKMR organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit duke bashkëpunuar me institucione të tjera për të kryer detyrat e saj funksionale në kuadër të rehabilitimit dhe riintegrit të të miturve/të rinjve në konflikt me ligjin.

Në vijim të funksionimit pasi janë evidentuar problematika sa i takon përcaktimit të saktë të fushës së veprimtarisë së institucionit dhe në kuadër të përcaktimit të kompetencave të Qendrës në mënyrë të qartë, lindi nevoja për ndryshimin e vendimi nr. 314, datë 15.05.2019, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, me qëllim përcaktimin e kompetencës për mbështetjen e të miturve në konflikt me ligjin dhe atyre të liruar me kusht sipas nenit 64 të Kodit Penal si dhe nenit 133, të Kodit të Drejtësisë Penale, për të Mitur.

Pas ndryshimeve në vendimin nr. 314, datë 15.05.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, me vendimin nr. 656, datë 10.10.2022, të Këshillit të Ministrave, është parashikuar se “Qendra ka një rol kyç në ushtrimin e veprimtarive parandaluese nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në

kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpres të miturit e rikthyer pas përfundimit të periudhës së dënimit, kjo me qëllim rritjen e edukimit publik mbi veprimtaritë kriminale, dënimet penale si dhe shpërndarjen e informacionit mbi zgjidhje konkrete”.

Konkretisht me ndryshimet në vendimin nr. 655, datë 10.10.2022, të Këshillit të Ministrave, për ndryshimin e VKM-së nr. 149, datë 20.03.2019, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit të të dhënave parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, Qendra është renditur në listën e institucioneve përgjegjëse dhe përdorues për sistemin e integruar, pra hedhëse të dhënash në sistem.

Gjithashtu në germën “d” të pikës 3, të VKM nr. 149, datë 20.03.2019, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit të të dhënave parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, të ndryshuar është parashikuar se:

“Përveç të drejtave të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, “Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka të drejtë përdorimi, leximi, shkrimi dhe gjenerimi të të dhënave të hedhura nga përdoruesit e tjerë në sistem me qëllim grumbullimin e të dhënave, përpunimin e tyre statistikor, analizimin dhe përgatitjen e raporteve në kuadër të parandalimit e kriminalitetit dhe recidivizmit për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve realizon raporte periodike për Ministrinë e Drejtësisë për funksionimin dhe mbarëvajtjen e sistemit.”.

Shtyllat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit janë **Parandalimi, Rehabilitimi dhe Riintegrimi**, dhe në këtë kontekst pasqyrohet dhe misioni kryesor i institucionit, në “*realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit apo lirimit me kusht*”.

Në funksion të realizimit të këtij misioni, institucioni ynë ushtron dhe veprimtari parandaluese nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese, në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit, apo lirimit me kusht.

Sipas përcaktimeve të germës “a”, të pikës II, të VKM-së nr. 314, datë 15.05.2019, “Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, përcaktohet se QPKMR, bashkëpunon me Shërbimin e Provës dhe/ose me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur në:

- i) përgatitjen e dokumentit për lirimin me kusht, vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/mjedisor dhe të nevojave të të miturit jashtë IEVP-së;

- ii) përgatitjen e planit individual të rishoqërizimit dhe të rehabilitimit, sipas programeve të shërbimeve;
- iii) përgatitjen e planit të menaxhimit të riskut, në rast të identifikimit të rrezikut të mesëm apo të lartë për recidivizëm;
- iv) ndjekjen, mbikëqyrjen dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike, arsimore, shëndetësore dhe situatën sociale të të miturit pas dënimit;
- v) administrimin në dosje të posaçme të kopjes së dokumentacionit individual të të miturit, të lëshuara nga Shërbimi i Provës dhe administrata e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të miturin.

I. Për sa më sipër, në kuadër të bashkëpunimit me Institutin e të Miturve Kavajë dhe Shërbimin e Provës janë marrë hapa konkrete për mbarëvajtjen e punës midis këtyre institucioneve dhe QPKMR-së, kjo si rezultat i faktit që roli dhe funksioni i Qendrës të jetë i qartë nga institucionet me të cilat do të bashkëpunohet.

➤ **Në kuadër të bashkëpunimit me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, evidentojmë se nga ana e institucionit tonë janë trajtuar 32 raste me të mitur të liruar nga Instituti i të Miturve Kavajë.**

Referuar rasteve të trajtuara nga QPKMR, më poshtë po ju përcjellim një pasqyrë të ecurisë së të miturve pas lirimimit nga IM Kavaja:

- 3 të mitur kanë ndjekur kurse profesionale
- 2 të mitur janë në pritje të fillimit të një kursi profesional
- 9 të mitur janë rikthyer në shkollë
- 8 të mitur janë me masë sigurie “arrest shtëpie”
- 2 të mitur janë rikthyer në IM Kavajë, si recidivistë
- 2 të mitur kanë emigruar jashtë vendit
- 5 të mitur nuk kanë pranuar asnjë shërbim nga QPKMR
- 1 i mitur me shtetësi të huaj është transferuar në vendin e origjinës, trajtimi i tij është jashtë kompetencave të QPKMR.

Aktualisht në Institutin e të Miturve Kavajë gjenden **30 të mitur**, nga të cilët:

- 9 raste që janë duke vuajtur dënimin me vendim të formës së prerë
- 21 raste me masë arresti paraburgim

Vlen të theksojmë linjën e bashkëpunimit të vendosur me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të miturin në lidhje me administrimin në dosje të posaçme të kopjes së dokumentacionit individual të të miturit në konflikt me ligjin.

Në këtë kontekst dhe në vijim të një bashkëpunimi të frytshëm me administratën e Institutit të të Miturve Kavajë, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve është angazhuar

vazhdimisht me nisma dhe aktivitete të ndryshme, me qëllim ofrimin e një mjedisi miqësor për të miturit që gjenden në ambientet e vuajtjes së dënimit.

➤ **Në kuadër të arritjes së qëllimit dhe misionit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe ofrimit të sa më shumë mundësive për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, për periudhën Janar – Dhjetor 2024, janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit, si më poshtë:**

- Marrëveshje bashkëpunimi me Futboll Klub Partizani, me qëllim përfshirjen në aktivitete sportive të të miturve/të rinjve në konflikt me ligjin, në kuadër të riintegritit të tyre në shoqëri;
- Marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Regby me qëllim përfshirjen në aktivitete sportive të të miturve/të rinjve në konflikt me ligjin, në kuadër të riintegritit të tyre në shoqëri;
- Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën “OrArt” me qëllim për përfshirjen në aktivitete artistike të të miturve/të rinjve në konflikt me ligjin, në kuadër të riintegritit të tyre në shoqëri.
- Nënshkrimi i marrëveshjes ndërinstitucionale mbi drejtësinë penale për të mitur në Shkodër.

Gjithashtu në bashkëpunim me CARITAS Albania, në kuadër të projektit “Shtegu i Mundësive”, me fokus rehabilitimin dhe riintegrimin të miturve të cilët janë rikthyer në shoqëri pasi kanë përfunduar dënimin, duke zhvilluar takime të shumta periodike me të miturit në të gjithë territorin e vendit. Në këtë kuadër janë ofruar dhe shërbime psikologjike, mbështetje konkrete në punësim, edukim, financim për iniciativat ekonomike, si dhe konsultim i vazhdueshëm me familjen dhe komunitetin për t’i ofruar mbështetjen e nevojshme.

➤ **Në mënyrë që procesi i parandalimit të jetë sa më gjithëpërfshirës, QPKMR ka organizuar aktivitete të ndryshme si më poshtë:**

1. Takimi i organizuar në kuadër të Projektit "7x7" - Parandalimi i dhunës dhe i krimit të të rinjtë përmes sensibilizimit dhe edukimit ligjor mes bashkëmoshatarësh, nga CFD Albania në qytetin e Kuçovës, Lezhës dhe Sarandës.

QPKMR në bashkëpunimin me mekanizmat institucional në funksion të Edukimit Ligjor të të Miturve dhe të Rinjve, zhvilloi këtë aktivitet në bashkëpunim me përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Ky takim ka vijuar me një zinxhir aktivitete që do të zbatohen në kuadër të Projektit "7x7".

“Parandalimi i dhunës dhe i krimit tek të rinjtë, përmes sensibilizimit dhe edukimit ligjor mes bashkëmoshatarësh”, është aktiviteti i zhvilluar me grupet e të rinjve në Kuçovë të cilët po aftësohen për t’u bërë trajnerë të bashkëmoshatarëve të tyre, si dhe në një zinxhir iniciativash në këtë kuadër, të cilat synojnë ta shndërrojnë edukimin ligjor të të rinjve në një detyrim qytetar.

2. Në kuadër të fushatës ‘Edukim ligjor në shkolla’, janë zhvilluar disa fushata sensibilizuese, në arsimin para universitar në të gjithë territorin e vendit, të pasqyruara në tabelën më poshtë:

Qyteti	Shkolla	Qyteti	Shkolla
Kukës	Shkolla 9 vjeçare “ Bajram Curri” Shkolla 9 vjeçare “Lidhja e Prizerenit” Gjimnazi “Havzi Nela”	Durrës	Shkolla 9 vjeçare “Naim Babameto” Gjimnazi “Naim Frashëri ” Shkolla 9 vjeçare “Bajram Curri ” Shkolla e mesme e Bashkuar “Jani Kukuzeli”
Vlorë	Gjimnazi “Jani Minga” Shkolla 9 vjeçare “Halim Xhelo” Gjimnazi “Ali Demi”	Elbasan	Shkolla 9 vjeçare “Jorgji Dilo ” Shkolla 9 vjeçare “ Qamil Guranjaku” Gjimnazi “Luigj Gurakuqi” Gjimnazi “Arianiti”
Orikum	Gjimnazi “Hasan Pulo” Shkolla 9 vjeçare “Balil Pelari”	Korçë	Shkolla 9 vjeçare “Ismail Qemali” Shkolla 9 vjeçare “Sevasti Qirjazi” Gjimnazi “Raqi Qirinxhi” Gjimnazi “Themistokli Gërmenji”
Fier	Shkolla 9 vjeçare “Andon Xoxa” Shkolla 9 vjeçare “ Naim Frashëri” Shkolla 9 vjeçare “Marke Dashi” Shkolla 9 vjeçare “ Pinallopi Pirro”	Tiranë	Shkollën ‘Vatra e Dijes’ Gjimazin ‘Asim Vokshi’ Gjimazin ‘Qemal Stafa’ Shkollën ‘Andon Zako Cajupi’
Lushnje	Shkolla 9 vjeçare “4 Deshmorët” Shkolla 9 vjeçare “ Kongresi I Lushnjës” Shkolla 9 vjeçare “Liri Kazazi” Gjimnazi “Vath Korreshi ”		

3. Në kuadër të projektit “Summer School”, QPKMR ka zhvilluar përgjatë 10-javëve në muajin korrik dhe gusht aktivitete me tematika nga më të ndryshmet, pranë Institutit të të Miturve Kavajë.

Projekti kishte si synim dhënien e njohurive dhe informacioneve për të miturit vuajnë dënimin në IEVP Kavajë. Në kuadër të projektit janë realizuar aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese, argëtuese, informuese dhe sensibilizuese me të miturit dhe të rinjtë e Institutit të të Miturve Kavajë.

4. Takime në kuadër të bashkëpunimit me International Police Organization.

- Konferenca e dytë për parandalimin e drogës tek të rinjtë në bashkëpunim me IPO dhe ASHDMF.

IPO së bashku me QPKMR, Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve dhe me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, organizuan Konferencën e Dytë Ndërinstitucionale me temë “Parandalimi i Përdorimit të Drogës nga të Rinjtë.

- Roli i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në fushën e policimit në komunitet.

Në kuadër të rëndësisë së Këshillave Vendor të Sigurisë Publike në komunitete, janë zhvilluan dy takime, në fushën e policimit në komunitet dhe koordinimit ndërinstitucional, në qytetin e Elbasanit dhe Fierit si më poshtë vijon:

- Takim mbi adresimin e sfidave mbi rëndësinë e komunikimit dhe koordinimit ndërinstitucional për parandalimin e incidenteve në shkolla dhe mirëqenien sociale të fëmijëve.
- Takim me temë: “Rritja e kapaciteteve institucionale dhe edukimin qytetar për parandalimin e krimeve, menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në komunitet”, në Bashkinë Gramsh.

5. Takime të organizuara nga AKCESK me fokus mbrojtjen e fëmijëve nga Krimi Kibernetik.

➤ **QPKMR, synon përfshirjen sa më efektive në komunitet të të miturve autorë të veprave penale nëpërmjet programeve rehabilituese. Në kuadër të rehabilitimit, janë organizuar disa takime dhe tryeza të rrumbullakëta në bashkëpunim me institucionet bashkërenduese si më poshtë:**

- Takime me punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në të gjithë Republikën e Shqipërisë, konkretisht Tiranë, Korçë, Gjirokastër, Shkodër, Durrës, Lezhë, Gramsh, Fier, Malësi e Madhe për ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve të të miturve në kontakt/konflikt me ligjin.

- Pjesëmarrje në projektin Upshift të organizuar në IM Kavajë. (Projekti u aplikua në IM Kavajë, ku përfaqësues nga QPKMR morën pjesë si mentorë. Qëllimi i projektit ishte inkurajimin e të miturve për tu qenë novatorë në ide dhe projekte të realizuara. Në këtë kuadër të rinjtë patën mundësinë të punonin për të ideuar zgjidhje të qëndrueshme se bashku me mentorët e tyre. Në përfundim të këtij aktiviteti u ndanë çmime për secilin projekt.)
- Zhvillimi i disa takimeve me z. Remz Privat, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Zhvillimi i aktivitetit pranë Kinema Agimi me qëllim kryesor ndërgjegjësimin për drejtësinë për të miturit dhe për të promovuar bashkëpunimin e vazhdueshëm midis Qendrës dhe Ambasadës Franceze në Shqipëri, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtës së Fëmijës më datë 20 Nëntor, u zhvillua.
- Zhvillimi i workshopit pranë Ambasadës Franceze në Shqipëri, me qëllim zhvillimin e diskutimeve me ekspertët mbi nevojat e vendit në zbatimin e drejtësisë për të miturit dhe mbi perspektivat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve franceze dhe shqiptare në këtë fushë.
- Zhvillimi i diskutimeve dhe shkëmbimeve të eksperiencave mbi drejtësinë penale për të mitur në Shkollën e Magjistraturës në Shqipëri.

➤ **Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të punonjësve, për periudhën Janar-Dhjetor 2024, Qendra ka marrë pjesë në disa trajnime si më poshtë:**

- Workshop në Fakultetin e Shkencave Sociale Tiranë, në kuadër të vlerësimit të kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore në planifikimin, hartimin dhe zbatimin e programeve dhe aktiviteteteve që mbështesin ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme sociale dhe të sjelljes.
- Seminar në qytetin e Lezhës organizuar nga UNICEF, ku u diskutua lidhur me Rolin e Policisë në zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur dhe Ligjit për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Gjithashtu për veprimtarinë e QPKMR dhe rastet e të miturve.
- Webinar to officially introduce the ToT on child-friendly legal aid, organizuar nga UNICEF ECARO.
- Seminar dy ditor në Tiranë me prezencën e OSBE në Shqipëri, Policisë Suedeze dhe Iniciativës Gjermane për parandalimin e kriminalitetit të të miturit, me në fokus bashkëpunimin ndërkombëtar në parandalimin e krimit tek të rinjtë.
- Pjesëmarrja në Forumin e Dialogut Rinor të Evropës Juglindore “Rinia për parandalimin e Krimit të organizuar dhe korrupsionit”, i mundësuar nga OSCE, i zhvilluar përgjatë 4 ditëve, në datat 21-25 maj 2024.

➤ **Në kuadër të promovimit të misionit të QPKMR:**

- Qendra ka realizuar dhe publikuar 1 spot promovues, në kuadër të promovimit të rasteve të suksesit si dhe 2 vjetorit të bashkëpunimit me Caritasin;
- Është promovuar libri *“Nevojat e të miturve në konflikt me ligjin dhe përshtatja e programit rehabilitues, Ndërthurja e analizës dhe veprimi”*, në Fakultetin e Shkencave Sociale. Në libër prezantohet koncepti i programit rehabilitues dhe riintegruës, duke përfshirë dhe shpjeguar konceptet themelore si rehabilitimi, riintegrimi, programi dhe roli i drejtësisë restauruese.

➤ **Takime të realizuara dhe marrje pjesë në konferenca në nivel ndërkombëtar/rajonat**

Gjatë vitit 2024, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka realizuar takime dhe ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare si më poshtë vijon:

- Pjesëmarrja e delegacionit shqiptarë në Gjermani, me qëllim njohjen e strukturave homologe, ky takim është realizuar me mbështetjen e Iniciativës Gjermane për Parandalimin e Kriminalitetit të të Miturit dhe OSCE.
- Pjesëmarrja në mbledhjen e posaçme për parandalimin e kriminalitetit të të rinjtë të organizuar nga Këshilli i Sigurisë së OSCE në Vjenë, ku QPKMR ndau praktikat më të mira për parandalimin e kriminalitetit të të rinjtë.

II. Në funksion të rolit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) si një institucion i cili grumbullon të dhëna, bën përpunimin e tyre statistikor, analizimin dhe përgatitjen e raporteve në kuadër të parandalimit të kriminalitetit dhe recidivizmit për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, dhe me predispozitën që sistemi të jetë sa më efektiv është vijuar me monitorimin e tij dhe mbajtjen e kontakteve me personat përgjegjës në institucioneve përdoruese, me qëllim popullimin me të dhënat që gjeneron çdo institucion sipas fushës së veprimtarisë së tij.

Për të siguruar një funksionim të mirë dhe zhvillimin e Sistemit të integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, QPKMR përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 ka organizuar disa takime dhe trajnime me mbikëqyrësit e sistemit, të mbajtura konkretisht në periudhën kohore nga muaji maj deri në muajin tetor 2024. Këto takime dhe trajnime përfshijnë të gjitha institucionet përdoruese të sistemit si Policinë, Prokurorinë, Gjykatën, IEVP-në për të mitur, Shërbimin e Provës, QPKMR-në, si dhe ekspertët e kontraktuar nga UNICEF.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë organizuar 6 (gjashtë) trajnime online, me fokus forcimin e kapaciteteve sa i takon rolit të përdoruesve të sistemit si hedhës të dhënash.

Gjithashtu është realizuar një trajnim specifik për mbikëqyrësit nga çdo institucion përgjegjës për përdorimin e sistemit. Më 23 maj 2024, u zhvillua trajnimi online me pjesëmarrjen e përfaqësueses nga Prokuroria e Korçës dhe të Gjirokastrës.

Ky trajnim kishte për qëllim thellimin e njohurive mbi rolin e tyre si përdorues të sistemit si dhe përmirësimin e aftësitësive teknike për hedhjen e të dhënave. Aktiviteti ishte pjesë e një serie trajnimesh që do të vijojnë nëse do të jetë e nevojshme në mbështetje të përdoruesve të këtij sistemi. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njohën më në detaje me teknikalitetet e funksionimit të sistemit dhe procesin e hedhjes së të dhënave.

Ekspertët e kontraktuar nga UNICEF, prezantuan përmes një demonstrimi praktik rastin konkret, duke ilustruar hapat kryesorë të punës në platformën “drejtesipertemitur”. Këto trajnime synojnë të sigurojnë një përdorim efikas të sistemit, duke mbështetur më tej përmirësimin e procesit të menaxhimit të të dhënave në drejtësinë penale për të mitur.

Më 13 dhe 14 qershor 2024, u zhvilluan dy trajnime online me përfaqësuesit e Zyrave Territoriale të Shërbimit të Provës. Trajnimi i datës 13 qershor përfshiu pjesëmarrjen e ekspertëve të UNICEF-it, përfaqësuesve nga QPKMR, si dhe përfaqësuesve nga Degët Territoriale të Shërbimit të Provës. Në këtë sesion morën pjesë 6 përdorues të rinj dhe 3 përdorues me përvojë nga Shërbimi i Provës. Ndërkohë, në trajnimet e datës 14 qershor, po ashtu morën pjesë ekspertët e UNICEF-it, përfaqësues nga QPKMR, dhe përfaqësues nga Degët Territoriale të Shërbimit të Provës, duke përfshirë 6 përfaqësues të tjerë.

Më pas, në datë 21 tetor 2024, pranë zyrave të UNICEF-it, Sektori i Mbikëqyrjes, Administrimit të Sistemit Elektronik dhe Statistikave, në bashkëpunim me ekspertët e kontraktuar nga UNICEF organizuan trajnimin me të gjithë mbikëqyrësit e institucioneve përgjegjëse për Sistemin e Integruar, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre për mbikëqyrjen e sistemit dhe nxjerrjen e raporteve të ndryshme sipas nevojave të institucioneve, si dhe aftësimin e tyre për trajnimet e përdoruesve të rinj për sistemin në vazhdimësi për institucionin e tyre. Në këtë trajnim morën pjesë 8 përfaqësues nga institucionet përkatëse dhe ekspertët e UNICEF-it.

Gjatë trajnimit u shpjegua në detaje procesi i trajnimit në vazhdimësi për përdoruesit e rinj dhe atyre ekzistues të sistemit. Ekspertët demonstruan raste praktike në sistemin Demo, duke ilustruar metodologjinë e përdorimit të sistemit.

Një arritje e rëndësishme në këtë proces është përfundimi dhe miratimi i modulit për hedhjen e të dhënave nga QPKMR, në bashkëpunim me ekspertët e UNICEF, modul i cili i është përcjellë dhe AKSHI-t për ta integruar në Sistemin e Integruar, por që moduli i QPKMR nuk është shtuar ende në sistem. Ky zhvillim do t'i mundësojë stafit të QPKMR-së që të vazhdojë hedhjen e të dhënave në Sistemin e Integruar në mënyrë të rregullt dhe të qëndrueshme konform legjislacionit në fuqi.

Në vijim, në datë 31 tetor 2024, pranë zyrave të UNICEF-it, Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), në bashkëpunim me ekspertët e kontraktuar nga UNICEF organizuan një trajnim specifik për stafin, me qëllim hedhjen e të dhënave në sistem dhe popullimin e tij me rastet e të miturve të ndjekur dhe trajtuar nga QPKMR.

Gjithashtu, në bashkëpunim me ekspertët e UNICEF-it, u hartua dhe finalizua manuali TOT për Sistemin e Integruar, manual i cili ju është dërguar në rrugë shkresore të gjitha institucioneve sikurse jeni në dijeni së bashku me paketën e plotë të dokumentacionit përkatës.

Ky manual trajnimi, i strukturuar në mënyrë të detajuar dhe hap pas hapi, do të shërbejë si një udhëzues i qartë dhe praktik për mbikëqyrësit e Sistemit të Integruar të institucioneve, për mbikëqyrjen dhe efikasitetin e Sistemit të Integruar.

Për sa i takon mbarëvajtjes dhe funksionimit të Sistemit të Integruar do të evidentonim problematikën e mosfunksionimit total të tij të herëpashershëm dhe konkretisht sistemi ka qenë jashtë funksionit nga muaji janar deri në muajin prill 2024 dhe aktualisht vazhdon të mos funksionojë që prej muajit tetor 2024.

Mungesa e mirëmbajtjes së sistemit mbetet një sfidë e madhe, e cila ndikon negativisht në performancën dhe efektivitetin e tij. Kjo situatë krijon vështirësi për përdoruesit e institucioneve, duke sjellë vështirësi në hedhjen e të dhënave dhe moskoherencë në shifrat statistikore të cilat analizohen nga ana jonë.

Me predispozitën që Sistemi i Integruar të jetë sa më eficient, QPKMR ka vijuar me monitorimin e Sistemit dhe mbajtjen e kontakteve me personat përgjegjës të institucioneve përdoruese, duke përcjellë më pas çdo problematikë për zgjidhje pranë Ministrisë së Drejtësisë.

➤ **Situata e hedhjes së të dhënave/popullimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur nga institucionet kompetente për periudhën Janar – Dhjetor 2024.**

Situata e hedhjes së të dhënave në sistem nga institucionet përgjegjëse (Polici, Prokurori, Shërbim Prove, I EVP për të mitur Kavajë, Gjykatë Shkallës Parë, Gjykatë Apeli, Gjykata e Lartë) rezulton e pasqyruar në një panoramë të përgjithshme si më poshtë:

- Në sesionin “*Të Mitur*”, nga ku gjenerohet raporti për të gjitha rastet e hedhura në Sistemin e Integruar nga institucionet përdoruese për periudhën Janar - Dhjetor 2024 rezultojnë 829 raste dhe në total rezultojnë që janë hedhur 5748 raste.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, drejtoritë vendore të policisë dhe/ose drejtoritë vendore për kufirin dhe migracionin **- 634 raste**

Në total janë hedhur **4703 raste**

- Zyrat/seksionet e prokurorive në nivel rrethi dhe apeli, që hetojnë çështje penale me të mitur; **- 236 raste**

Në total janë hedhur **1583 raste**

- Gjykata e Lartë **- 0 raste**

- Gjykatat/seksionet në nivel rrethi dhe apeli, që gjykojnë çështje penale me të mitur; **- 0 raste**
- Zyrat Territoriale të Shërbimit të Provës që trajtojnë rastet e të miturve me masë shmangieje ose masë alternative të dënimit me burgim, si dhe hartimi i Raportit të Vlerësimit Individual për të miturin në konflikt me ligjin. **- 186 raste**

Në total janë hedhur **804 raste**

- Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, ku ndodhen të miturit e dënuar ose të paraburgosur; **- 31 raste**

Në total janë hedhur **86 raste**

- Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) **- 0 raste**

QPKMR, do të vazhdojë hedhjen e të dhënave në sistem në momentin e krijimit të modulit të krijuar në sistem.


➤ **Referuar të dhënave të hedhura nga përdoruesit e Sistemit të Integruar përgjatë vitit 2024, situata rezulton si më poshtë vijon:**

Policia – rezulton me 634 raste të hedhura gjithsej në periudhën Janar – Dhjetor 2024, ndërsa Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër rezulton pa të dhëna në sistem.

Të dhënat e hedhura në Sistemin e Integruar sipas Drejtorive Vendore të Policisë rezultojnë si më poshtë:

- DVP Kukës – 49 raste (Total raste të hedhura 222 raste)
- DVP Berat – 28 raste (Total raste të hedhura 231 raste)
- DVP Korçë – 181 raste (Total raste të hedhura 584 raste)
- DVP Elbasan – 1 rast (Total raste të hedhura 94 raste)
- DVP Gjirokastrë – 88 raste (Total raste të hedhura 281 raste)
- DVP Fier – 141 raste (Total raste të hedhura 640 raste)
- DVP Lezhë – 0 raste (Total raste të hedhura 312 raste)
- DVP Vlorë – 52 raste (Total raste të hedhura 310 raste)
- DVP Tiranë – 38 raste (Total raste të hedhura 1815 raste)
- DVP Durrës – 5 raste (Total raste të hedhura 111 raste)
- DVP Dibër – 51 raste (Total raste të hedhura 102 raste)

Situata e pasqyruar në formë grafike si më poshtë:




- IEVP për të mitur Kavajë – rezulton të jenë hedhur gjithsej në Sistemin e Integruar për periudhën Janar – Dhjetor 2024, **31 raste**.

Në total janë të hedhura në Sistemin e Integruar **86 raste** nga të cilat:

- **75 raste** me masë arresti paraburgim
- **11 raste** që vuajnë dënim me burg

Duke qenë se kolona që tregon datën e regjistrimit të rastit në shumicën e herëve është e paplotësuar nuk mund të realizojmë një pasqyrë të qartë të rasteve të hedhura për këtë 1-vjeçar, por është bërë një analizë krahasuese me numrin e rasteve të pasqyruara në raportet aktualë dhe atyre të kryera më përpara.

Situata e pasqyruar në formë grafike si më poshtë:



- Shërbimi i Provës - rezulton të jenë hedhur gjithsej në Sistemin e Integruar për masat alternative të dënimit me burg për periudhën Janar – Dhjetor 2024, **27 raste**.


Në total janë të hedhura në Sistemin e Integruar **86 raste**.

Situata e të dhënave të hedhura në Sistemin e Integruar është e pasqyruar si më poshtë:

- **2 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Tiranë. (Në total janë hedhur 69 raste)
- **4 raste** i hedhur nga Dega Territoriale Korçë. (Në total janë hedhur 21 raste)
- **2 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Vlorë. (Në total janë hedhur 12 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Shkodër. (Në total janë hedhur 7 raste)
- **0 rast** i hedhur nga Dega Territoriale Lushnje. (Në total është hedhur 1 rast)
- **3 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Elbasan. (Në total janë hedhur 33 raste)
- **0 raste** të hedhur nga Dega Territoriale Berat. (Në total është hedhur 1 rast)
- **2 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Pogradec. (Në total janë hedhur 5 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Lezhë. (Në total janë hedhur 10 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Pukë. (Në total është hedhur 1 rast)
- **1 rast** i hedhur nga Dega Territoriale Kukës. (Në total janë hedhur 11 raste)
- **9 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Fier. (Në total janë hedhur 25 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Krushjë. (Në total janë hedhur 2 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Përmet. (Në total janë hedhur 2 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Kavajë. (Në total është hedhur 1 rast)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Kurbin. (Nuk ka raste të hedhura)

- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Mat. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Durrës. (Në total janë hedhur 14 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Sarandë. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Dibër. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Gjirokastrë. (Nuk ka raste të hedhura)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Tropojë. (Nuk ka raste të hedhura)

Situata e pasqyruar në mënyrë grafike është si më poshtë:



- Shërbimi i Provës ku rastet me masa alternative për shmangien nga ndjekja penale rezultojnë me **3 raste** të hedhura për periudhën Janar – Dhjetor 2024.

- Rastet me masa alternative për shmangien nga ndjekja penale rezultojnë **10 raste** të hedhura në total në sistem nga Degët Territoriale të Shërbimit të Provës dhe konkretisht:


- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Shkodër. (Në total janë hedhur 3 raste)
- **1 rast** i hedhur nga Dega Territoriale Vlorë. (Në total janë hedhur 2 raste)
- **1 rast** i hedhur nga Dega Territoriale Korçë. (Në total janë hedhur 4 raste)
- **1 rast** i hedhur nga Dega Territoriale Fier. (Në total është hedhur 1 rast)

- Shërbimi i Provës rastet me lirim me kusht – nuk është hedhur asnjë e dhënë.

- Shërbimi i Provës, Raporti Individual i Vlerësimit për të miturin në konflikt me ligjin – rezultojnë **156 raste** të hedhura për periudhën Janar – Dhjetor 2024 në Sistemin e Integruar dhe në total janë **575 raste** të hedhura nga degët territoriale të Shërbimit të Provës, nga të cilat:

- **4 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Pukë. (Në total janë hedhur 8 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Shkodër. (Në total janë hedhur 40 raste)
- **0 raste** të hedhur nga Dega Territoriale Sarandë. (Në total janë hedhur 25 raste)
- **3 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Pogradec. (Në total janë hedhur 25 raste)
- **12 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Korçë. (Në total janë hedhur 28 raste)
- **31 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Fier. (Në total janë hedhur 106 raste)
- **48 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Kukës. (Në total janë hedhur 81 raste)
- **11 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Vlorë. (Në total janë hedhur 14 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Berat. (Në total është hedhur 1 rast)
- **9 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Tiranë. (Në total janë hedhur 64 raste)
- **7 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Lezhë. (Në total janë hedhur 82 raste)
- **10 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Lushnje. (Në total janë hedhur 27 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Krujë. (Në total janë hedhur 23 raste)
- **3 rast** të hedhur nga Dega Territoriale Elbasan. (Në total janë hedhur 11 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Kavajë. (Në total janë hedhur 6 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Dega Territoriale Durrës. (Në total janë hedhur 16 raste)
- **0 rast** të hedhur nga Dega Territoriale Përmet. (Në total janë hedhur 4 raste)
- **0 rast** të hedhur nga Dega Territoriale Dibër. (Në total është hedhur 1 rast)

Situata e pasqyruar në mënyrë grafike është si më poshtë:




- Prokuroria rezulton me **236 raste** të hedhura për periudhën Janar – Dhjetor 2024, ndërsa në total rezultojnë të hedhura në Sistemin e Integruar **1583 raste** nga të cilat:

- **46 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Fier. (Në total janë hedhur 142 raste)
- **2 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Lezhë. (Në total janë hedhur 107 raste)
- **7 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Dibër. (Në total janë hedhur 49 raste)
- **0 raste** i hedhur nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Krujë. (Në total janë hedhur 44 raste)
- **29 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Kukës. (Në total janë hedhur 88 raste)
- **4 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Durrës. (Në total janë hedhur 98 raste)
- **0 raste** të hedhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës. (Në total janë hedhur 27 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Pogradec. (Në total janë hedhur 23 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Mat. (Në total janë hedhur 66 raste)
- **33 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Berat. (Në total janë hedhur 129 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Tropojë. (Në total janë hedhur 17 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Korçë. (Në total janë hedhur 63 raste)
- **56 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Elbasan. (Në total janë hedhur 181 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Pukë. (Në total janë hedhur 2 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Gjirokastër. (Në total janë hedhur 5 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Kavajë. (Në total janë hedhur 27 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Përmet. (Në total janë hedhur 8 raste)
- **37 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Sarandë. (Në total janë hedhur 139 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Lushnje. (Në total janë hedhur 58 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Tiranë. (Në total janë hedhur 174 raste)

- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Shkodër. (Në total janë hedhur 41 raste)
- **17 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Vlorë. (Në total janë hedhur 73 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. (Në total janë hedhur 2 raste)
- **0 raste** të hedhura nga Prokuroria pranë Gj. Rreth. Gjyq. Kurbin. (Në total janë hedhur 18 raste)
- **0 rast** i hedhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. (Në total është hedhur 1 rast)
- **0 rast** i hedhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. (Në total është hedhur 1 rast)

Situata e pasqyruar në mënyrë grafike është si më poshtë:



- Gjykata (Shkalla I, Apeli, E Lartë) – rezulton se nuk ka asnjë të dhënë të hedhur.

Në lidhje me përdorimin e Sistemit të Integruar nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit, vlen të theksohet se i gjithë stafi i administratës gjyqësore është trajnuar plotësisht nga ekspertët e UNICEF dhe QPKMR ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me mbikëqyrësin e KLGJ, për përdorimin e sistemit edhe nga gjykatat.

Pas vënies në funksionim të sistemit, pritet që të fillojë popullimi i sistemit edhe nga përdoruesit e gjykatave.

➤ Problematika

Nga mbikëqyrja e sistemit dhe komunikimeve të vazhdueshme të mbajtura me personat përgjegjës nga institucionet përdoruese, QPKMR, evidenton se ekzistojnë problematikat si më poshtë vijon:

- Mosfunksionimi total i sistemit që prej 31 tetor 2024.
- Popullimi i ulët nga një pjesë e institucioneve përdoruese, ku konkretisht Shërbimi i Provës rezulton të hedh një numër të vogël rastesh në sistem.
- Drejtoritë Vendore të Policisë evidentohet se nuk hedhin të dhëna në lidhje me arsyen e regjistrimit fillestar (dëshmitar, viktime, autor i veprës penale); statusin përfundimtar (si është proceduar me rastin).
- Gjykatat nuk kanë hedhur të dhëna, sipas Udhëzimit të KLGJ nr. 427, datë 14.10.2022 “*Për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në Sistemin e Integruar të të Dhënave Të Drejtësisë Penale për të Mitur, nga Gjykatat e Republikës së Shqipërisë*”.
- IEVP në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar nuk ka të përcaktuar datën e regjistrimit, datën e lirimit, kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit/paraburgimit nga i mituri, mosha, statusi familjar.
- Shërbimi i Provës në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar, nuk ka të hedhur përfundimin e ekzekutimit, i papërcaktuar në disa raste është dhe statusi i çështjes. Nuk është vijuar me hedhjen e rasteve me masë alternative shmangie dhe në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar për shmangiet nga ndjekja penale në 4 raste nga 10 raste të hedhura gjithsej nuk paraqitet e hedhur mosha e të miturit.
- Prokuroria në disa raste nuk ka të hedhura statusin përfundimtar dhe arsyen përkatëse, si dhe nuk ka kolonë për përcaktimin e gjinisë të të miturit.
- QPKMR nuk ka vijuar me hedhjen e rasteve sipas modulit përkatës në sistem. Pavarësisht se është krijuar moduli për hedhjen e të dhënave nuk është implementuar akoma nga AKSHI në Sistem.
- Kryesisht tek të gjitha institucionet ka mangësi në plotësimin e të dhënave sipas indikatorëve përkatës, gjë e cila sjell mospasjen e statistikave të sakta. Nga komunikimet me institucionet përkatëse janë referuar problematika/vështirësi në hedhjen e të dhënave apo fshirja e informacionit të hedhur pasi verifikohet më pas. Gjithashtu dhe mosfunksionimi i sistemit ndikon ndjeshëm në ecurinë e punës.
- Në seksionin “*Të Mitur*” – në raportin që gjenerohet nga Sistemi i Integruar, sa i takon indikatorëve të raportit nuk është përcaktuar data e hedhjes së rastit, gjinia si dhe statusi përkatës.
- Mosrealizimi i shërbimit të mirëmbajtjes.

Në lidhje me problematikat e mësipërme, QPKMR ka vijuar me mbikëqyrjen në mënyrë të vazhdueshme të funksionimit të sistemit duke pasur në fokus efektivitetin e sistemit të Integruar, hedhjen e të dhënave si dhe duke ndjekur zhvillimet e situatës së Sistemit të Integruar në koherencë dhe me problematikat e institucioneve përdoruese.

III. MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar realizohet bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, si dhe në përputhje me fondet e vëna në dispozicion si më poshtë:

- Fonde te ardhura nga Ministria e Drejtësisë, për llogaritë ekonomike 600,601 dhe 602 janë si më poshtë:
 - Paga 23,000,000 lekë
 - Sigurime shoq. dhe shend. 4,000,000 lekë
 - Shpenzime operative 6,000,000 lekë
 - Fond i veçantë 124,000 lekë

Sipas shkresës nr. 1284/2 prot, datë 26.02.2024 nga Ministria e Drejtësisë ka ardhur fondi i investimeve prej 300,000 lekë i ndarë në zërat : Blerje pajisje elektronike në shumën 150,000 lekë dhe zëri Blerje Pajisje zyre në shumën 150,000 lekë. Në muajin 01.10.2024 me shkresën nr. 4485/3 prot nga Ministria e Drejtësisë , fondi prej 150,000 lekë në zërin pajisje zyre ka kaluar në zërin pajisje elektronike për shkak të nevojave më të mëdha në pajisje elektronike. Në llogarinë e fondit special është hedhur shuma 100,000 lekë sipas shkresës nr. 713/3 prot., 01.03.2024, si dhe shuma prej 24,000 lekë e cila është pakësuar nga llogaria ekonomike 602 dhe është shtuar në llogarinë ekonomike 606, sipas shkresës 799/2 datë 29.02.2024, nga Ministria e Drejtësisë. Llogaria ekonomike 602 (shpenzime operative) bëhet 5,976,000 lekë.

Përmbledhëse e fondeve të alokuara në tabelën më poshtë sipas rishikimeve të buxhetit :

Nr	Emërtimi	Shuma
1.	Fondi i pagave	23,000,000
2.	Fondi për sig shoqërore dhe shëndetësore	4,000,000
3.	Fondi për shpenzime operative me kod 91401AD	5,976,000
4.	Fondi special 606	124,000
5.	Investime	300,000
	Totali	33,400,000

Realizimi i fondeve për vitin janar –dhjetor 2024.

Nr.	Emërtimi	Plani vjetor	Fakti 12-mujor	% e realizimit
1.	Shpenzime për paga	23,000,000	21,601,049	93

2.	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,000,000	3,610,057	90
3.	Shpenzime operative	5,976,000	4,279,078	71
4.	Fond special	124,000	1,800	49
5.	Investime	300,000	185,511	62
	Totali	33,400,000	29,736,554	89%

- **Performanca analitike e buxhetit**

SHPENZIME PËR PAGA DHE SIGURIME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Buxheti i alokuar për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore është 27,000,000, i cili është realizuar në masën 93%. Fondi i pagave është realizuar në masën e planifikuar pasi struktura është plotësuar dhe nuk ka vende vakante.

SHPENZIMET OPERATIVE

Për shpenzimet operative fondi i alokuar është 5,976,000 lekë. Sipas regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike 2024, jepet realizimi zë më zë i shpenzimeve (llog. 602) në tabelën më poshtë:

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Buxheti	Realizimi	%
1	Kancelari	240,000	134,520	56
2	Materiale Pastrimi dhe dezinfektimi	360,000	198,144	55
3	Materiale zyre toner dhe bojëra printer	360,000	282,000	78
4	Furnizime me materiale te tjera zyre	76,000	73,710	97
5	Shpenzime printimi	240,000	188,268	78
6	Shërbime te tjera materiale speciale	166,000	97,000	58
7	Shpenzime uji	60,000	9,888	16
8	Shpenzime posta	18,000	8,380	47
9	Shërbime te tjera	120,000		
10	Mirëmbajtje faqe web	180,000	150,000	83

11	Karburant dhe lubrifikant	1,200,000	1,166,330	97
12	Pjese këmbimi (goma dhe bateri)	360,000	222,000	62
13	Taksa siguracion	40,000	38,121	95
14	Shërbime te tjera transporti	198,000	198,000	100
15	Bileta jashtë vendit	300,000		
16	Dieta jashtë vendit	190,000		
17	Dieta brenda vendit	400,000	337,000	84
18	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve	72,000	70,800	98
19	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve te zyrave	60,000	52,500	88
20	Qiramarrje ambientesh për aktivitete	300,000	141,200	47
21	Shpenzime përkthimi	120,000		
22	Shpenzime për tatime e taksa	86,000	81,217	94
23	Shpenzime për te tjera materiale dhe shërbime operative te paparashikuara Spot	830,000	830,000	100
	Totali me kod 91401AD	5,976,000	4,279,078	72

Realizimi i shpenzimeve operative (602) është në masën 72%, në shumën 4,279,078 lekë. Janë realizuar në masën gati 90% zërat karburant, shërbime operative, mirëmbajtje objekte, mirëmbajtje pajisje zyre, dieta etj.

Si zëra të paprekur për këtë vit mbeten: shërbime përkthimi në vlerën 120,000 lekë, shërbime të tjera, bileta jashtë vendit dhe dieta jashtë vendit të cilat zënë peshën 12% të llogarisë ekonomike 602 (shpenzime operative) në buxhetin e QPKMR-së.

INVESTIMET

Fondet për shpenzime kapitale në llogarinë ekonomike 231, për Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, janë përcjellë me shkresë nr. 1284/2 prot., datë 26.02.2024, nga Ministria e Drejtësisë përkatësisht:

- 150,000 lekë, kodi 18AQ405, Blerje pajisje elektronike
- 150,000 lekë, kodi 18AQ406, Blerje pajisje zyre

Nr	Emërtimi i investimeve	Buxheti	Realizimi	%
01	Blerje pajisje elektronike për QPKMR	150,000		
02	Blerje pajisje zyre për QPKMR.	150,000		

Në muajin 01.10.2024 me shkresën nr. 4485/3 prot nga Ministria e Drejtësisë , fondi prej 150,000 lekë në zërin pajisje zyre ka kaluar në zërin pajisje elektronike për shkak të nevojave më të mëdha në pajisje elektronike. Pajisjet elektronike shkojnë ne vlerën 300,000 lekë.

Fondet e investimeve janë realizuar në masën gati 62%.

Nr.	Emërtimi i investimeve	Buxheti	Realizimi	%
01	Blerje pajisje elektronike për QPKMR	300,000	185,511	62

Duke ju falënderuar për vëmendjen!